

## MBLEDHJA E TRETË E ASAMBLESË SË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË RPSH

Më 15 dhe 16 prill 1974 zhvilloi punimet mbledhja e tretë e Asamblesë të Akademisë së Shkencave të RPSH. Fernin pjesë anëtarë dhe anëtarë korrespondentë të Akademisë, drejtues të institucioneve kërkimore-shkencore, punonjës shkencorë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të tjerë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë së Shkencave, prof. Aleks Buda. Pastaj sekretari shkencor i Akademisë, prof. Bedri Dedja, i cili, sipas rendit të ditës, në emër të Presidiumit mbajti raportin Mbi veprimtarinë e Akademisë së Shkencave të RPSH gjatë vitit 1973, realizimet që janë arritur në fushat e ndryshme të shkencës si dhe drejtimit themelor të punës shkencore për vitin 1974 të institucioneve kërkimore që përshihen në kuadrin e Akademisë».

Pastaj sipas rendit të ditës u bë një konsultim dhe u diskutua për disa probleme të zhvillimit të shkencës sonë në periudhën e afërme.

Pas diskutimeve për pikën e parë dhe në dytë të rendit të ditës, Asambleja e

Akademisë miratoi unanimisht vendimet përkatëse për raportin vjetor dhe planin e punës shkencore për vitin 1974, si dhe për statutin e Akademisë së Shkencave të RPSH.

Në seancën e dytë prof. Aleks Buda referoi mbi rezultatet e vizitës së delegacionit të Akademisë së Shkencave të RPSH në Republikën Popullore të Kinës. Asambleja miratoi unanimisht veprimtarinë e delegacionit dhe e cilësoi atë si një kontribut për forcimin e mëtejshëm të miqësisë midis dy popujve, dy partive tona dhe bashkëpunimit midis dy akademive si dhe për zhvillimin e punës kërkimore—shkencore të Akademisë sonë të Shkencave.

Në fund Asambleja zgjodhi kryetarët e seksioneve si atë të shkencave shoqërore, të shkencave teknike dhe të shkencave natyrore. Kryetar i seksionit të shkencave shoqërore u zgjodh prof. Aleks Buda, kryetar i seksionit të shkencave teknike prof. Petrit Radovicka dhe kryetar i seksionit të shkencave të natyrës prof. Kolë Popa.

## SESIONI SHKENCOR «KONGRESI I DREJTSHKRIMIT DHE SHKOLLA»

Instituti i Studimeve Pedagogjike, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

organizuan në Shkodër më 24-25 maj sesionin shkencor «Kongresi i Drejtshkrimit dhe shkolla». Në sesion ishin

të pranishëm zëvendësministri i Arsimit dhe i Kulturës, Hasan Duma, sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës, Musa Kraja, pedagogë, punonjës shkencorë, mësues të gjuhës dhe të letërsisë të shkollës 8-vjeçare dhe të mesme e të ftuar të tjerë.

Në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në mënyrë të veçantë i bëhet thirrje shkollës që ta vlerësojë përvetësimin e normës së njësuar të gjuhës letrare e të drejtshkrimit të miratuar nga Kongresi si detyrë themelore. Ky sesion, që u organizua fill mbas vendimit të Këshillit të Ministrave «Mbi masat për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të gjuhës shqipe» dhe Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, pati si synim të vërë në dukje përpjekjet serioze që bëhen në shkollë gjatë procesit mësimor dhe jashtë shkollës për të vënë në jetë vendimet e Kongresit dhe detyrat që dalin, dhe njëkohësisht të shërbejë për përhapjen e përvetësimit të njësuar të shkollës sonë.

Sesionin e hapi drejtori i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, Mihal Prifti, i cili midis të tjerash theksoi rëndësinë e zbatimit të drejtshkrimit në shkollat tona.

Punimet sesioni i zhvilloi në dy seanca gjatë të cilave u mbajtën 21 kumtesa:

«Rrugët për një pregatitje më të mirë gjuhësore të studentëve në Institutin Pedagogjik, që pregatit mësues të gjuhës amtare» nga docenti Jup Kastri, «Vendi i kërkesave drejtshkrimore në mësimin e gjuhës» nga Sami Xhango, «Mbi rolin e letërsisë për fëmijë në formimin e gjuhës letrare të nxënësve» nga Pandora Dedja, «Disa mendime përfundimtare për drejtshkrimin e nxënësve» nga Engjëll Angoni, «Njohuritë teorike drejtshkrimore dhe shprehitë në procesin mësimor» nga Tomor Osmani, «Disa probleme për formimin e shprehive të drejtshkrimit në shkollën 8-vjeçare», nga Islam Dizdari, «Mbi zbatimin e normave të shqiptimit letrar në shkollë» nga Mina Gero, «Leximi letrar dhe

përpunimi i shprehive drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore tek nxënësit» nga Faik Luli, «Elemente të realizimeve gjuhësore që mund të futen në ciklin e ulët të shkollës 8-vjeçare» nga Shefik Osmani, «Përpjekje për zbatimin e rregullave të drejtshkrimit në shkollën 8-vjeçare» nga Romeo Qano, «Detyrat e mësuesve të gjuhës për problemet e drejtshkrimit në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare» nga Tonina Hido, «Puna me drejtshkrimin në shkollat e mesme pedagogjike» nga Fadil Podgorica, «Mbi rrugët e përmirësimit të mëtejshëm të punës me drejtshkrimin në shkollë» nga Hysen Qosja. Për rolin e teksteve shkollore dhe të mjeteve mësimore në formimin e shprehive drejtshkrimore u fol në kumtesat: «Teksti shkollor, mësuesi dhe formimi drejtshkrimor i nxënësit» nga Stefan Bulo dhe «Mjetet mësimore dialektike e teknike në funksion të drejtshkrimit» nga Kiço Kosta. Pati dhe kumtesa ku bëhej fjalë për çështje të veçanta të drejtshkrimit: «Mbi drejtshkrimin e diftongut ose togut zanor» nga Kolë Ashta dhe «Mbi drejtshkrimin e foljeve» nga Fatmir Agalliu.

Në këtë sesion shkencor u mbajtën edhe katër kumtesa nga bashkëpunëtorë shkencorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë: «Roli i shkollës në procesin e sotëm të afrimit të dialekteve me gjuhën letrare» nga bashkëpunëtori i vjetër Jorgji Gjinari, «Zbatimi i drejtshkrimit dhe çështjet stilistike të punës me gjuhën në shkollë» nga Xhevat Lloshi, «Mbi disa probleme të përvetësimit të sistemit fonologjik të gjuhës letrare» nga Bahri Beci dhe «Vendi i termave në gjuhën letrare» nga Ferdinand Leka.

Në fund e mori fjalën drejtori i Institutit të Studimeve Pedagogjike, doc. Nos Josifi, i cili nxori konkluzionet dhe vlerësoi punën e kumtuesve gjithashtu shtroi detyrat që dalin para shkollës sonë, para arsimtarëve për të vënë në jetë vendimin e Këshillit të Ministrave.